

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-043/14

**Prishtinë,
4 Dhjetor 2014**

Në çështjen juridike të:

D. J.

Serbi

Pala ankuese

kundër

Nuk dihet

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/204/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA26525), të datës 11 qershor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 4 Dhjetor 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e D. J. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/204/2013, (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA26525), i datës 11 qershor 2013.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/204/2013 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA26525), i datës 11 qershor 2013.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 14 mars 2007, D. J. (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar ri-posedimin e pronës që ndodhet në Komunën e Vitisë, Zona Kadastrale e Germovës, ngastra nr. 72/2, tokë kultivuese me sipërfaqe të përgjithshme prej 03.49.00 ha. Paraqitësi i kërkesës ka thënë se e ka humbur posedimin e pronës më 12 qershor 1999 për shkak të konfliktit të armatosur në vitet 1998/1999 dhe se e njëjta është e uzurpuar ilegalisht nga persona të panjohur, kështu që, përveç ri-posedimit ai kërkon edhe kompensimin për shfrytëzimin e pronës pa pëlqimin e tij.
2. Për ta mbështetur pretendimin e tij ai ka paraqitur në AKP dokumentet në vijim:
 - Kopjen e planit të datës 21 nëntor 1996 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, Komuna Kadastrale Gërmovë, ku tregon se prona e kërkuar është e regjistruar si pronë shoqërore në emër të Kooperativës Bujqësore "Morava".
 - Aktgjykimin e formës së prerë P.Br.181/96 i datës 06 janar 1997, lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë ku vërtetohet se kooperativa bujqësore "Agromorava" ishte e obliguar t'ia njoh të drejtën pronësore dhe të posedimit, si dhe ti lejojë bartjen e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar në emër të S. J. (nënës së paraqitësit të kërkesës) brenda 15 ditëve nga data e pranimit të aktgjykimin nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Kjo bartje do të kryhej nga Zyra për Kadastër e Vitisë.
 - Një certifikatë të vdekjes 203-1-46/99 e datës 15 mars 1999 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile e Komunës së Vrnjačka Banjës që tregon se S. J. kishte vdekur më 13 mars 1999.

- Vendim Trashëgimie, O.Br.139/99 të datës 19 korrik 1999, lëshuar nga Gjykata Komunale e Jagodinës. Sipas këtij vendimi, paraqitësi i kërkesës dhe vëllai i tij e kanë trashëguar pronën nga nëna e tyre e ndjerë, secili me nga ½ pjesë ideale.
- 3. Më 8 shkurt 2008, AKP-ja ka bërë identifikimin e pronës duke vendosur një shenjë te vendi ku ndodhej ngastra, ku thuhet se prona është objekt i kërkesës dhe se palët e interesuara mund të paraqesin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Askush nuk ka paraqitur përgjigje ndaj këtij njoftimi. Më 30 gusht 2010, AKP-ja përsëri e ka bërë njoftimin e kërkesës duke e publikuar në Gazetën e Njoftimeve nr. 7 dhe në Buletinin e zyrës për prona të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista i janë lënë pronarit të një kioske i cili u pajtua t'ia dorëzojë palëve të interesuara dhe në hyrje të fshatit Gërmovë. Të njëjtat publikime janë lënë në Gjykatën Komunale, Kuvendin Komunal, si dhe në disa zyre të autoriteteve kompetente komunale në Viti.
- 4. Brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, në pajtim me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, asnjë palë nuk ka shprehur interesim të merr pjesë në procedurë lidhur me pronën që është objekt i kërkesës; kështu që kërkesa mbetet e pakontestueshme.
- 5. Përveç vendimit për trashëgiminë, AKP-ja nuk ka mundur t'i verifikojë asnjë nga dokumentet e lartpërmendura.
Aktgjykimi P.Br.181/96 nuk është gjetur në Gjykatën Komunale të Vitisë e as në Gjykatën Komunale të Vranjës, ku ishin zhvendosur dokumentet e Gjykatës Komunale të Vitisë.
Në Gjykatën Komunale të Vitisë, të dhënat e vitit 1999 po mungonin dhe referenti i gjykatës ka thënë se gjykata nuk ka njohuri lidhur me klauzolën që dëshmon se aktgjykimi është i formës së prerë. Gjykata Komunale e Vranjes e ka vërtetuar se nuk janë transferuar të gjitha dokumentet nga Gjykata Komunale e Vitisë në Gjykatën Komunale të Vranjës.
- 6. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së më 5 mars 2008, *ex officio* ka gjetur Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme të lëshuar nga Komuna Kadastrale e Vitisë, që paraqet pronën e kërkuar si të pandarë dhe të regjistruar si pronë shoqërore në emër të Kooperativës Bujqësore "Morava".
- 7. Përsëri më 17 tetor 2011 Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e ka verifikuar Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme dhe prona e kërkuar është gjetur e pandarë (ngastra nr.72) dhe e regjistruar në emër të H. A. si qiramarrës për 99 vite. Azhurnimi është bërë në pajtim me deklaratën Nr. 1391/01 të datës 6 maj 2001 të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.
- 8. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së më 15 janar 2013 si përpjekje shtesë i ka dërguar një letër për Njoftimin e Refuzimit të Mundshëm të Kërkesës paraqitësit të kërkesës duke kërkuar nga ai paraqitjen e provave shtesë të cilat dëshmojnë të drejtën e pronësisë të nënës së tij, brenda afatit prej 30 ditëve. Paraqitësi i kërkesës ka pranuar letrën më 31 janar 2013, sidoqoftë, nuk është përgjigjur dhe nuk ka ofruar asnjë provë.

9. Me vendimin e vet KPCC/D/A/204/2013 të datës 11 qershor 2013, KKPK-ja e ka refuzuar kërkesën në fjalë.
10. Më 13 nëntor 2013, vendimi i është dorëzuar D. J. Ai ka paraqitur një ankesë pranë Gjykatës Supreme më 6 dhjetor 2013 (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese).

Pretendimet e palëve

11. Pala ankuese ka pretenduar se vendimi i KKPK-së mbështetet në vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale. Pala ankuese, tutje, ka pretenduar se pronësia ndaj pronës së kërkuar është vërtetuar me Aktgjykimin e formës së prerë P-181/96 që përcakton pronësinë e nënës së tij të ndjerë, S. J. Aktgjykimi P-181/96 gjithashtu ka vendosur për obligimin e palës përgjegjëse që ta kthej posedimin e pronës. Sipas palës ankuese, nëna e tij e ka marrë pronën e kërkuar në posedim në vitin 1997 dhe se ishte duke e shfrytëzuar deri kur vdiq më 19 mars 1999. Ndërsa pronësia e palës ankuese është vërtetuar me Vendim Trashëgimie të lëshuar nga Gjykata Komunale e Jagodinës. Në fund të ankesës, pala ankuese ka thënë se Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka mundur të shiste diçka që nuk i takonte. Askush nuk mund të bart më tepër të drejta tek dikush se sa që i takojnë, dhe prandaj, një palë e tretë nuk ka mundur të bëhet pronar në bazë të një kontrate të lidhur me dikë i cili nuk është pronar.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës:

12. Ankesa është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079. Gjykata Supreme e ka juridiksionin ndaj ankesave kundër vendimit të KKPK-së. Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

13. Gjykata Supreme pas vlerësimit të dosjes, vendimit të ankimuar dhe pretendimeve të palës ankuese, konsideron se ankesa është e pabazuar.

14. Një referim i veçantë i është bërë paragrafëve 106 dhe 108 të vendimit KPCC/D/A/204/2013. KKPK-ja ka theksuar se paraqitësi i kërkesës e ka paraqitur një Aktgjykim të formës së prerë të vitit 1996 përmes së cilit e drejta e pronësore ndaj pronës së kërkuar është bartur tek nëna e paraqitësit të kërkesës por që aktgjykimi nuk ka mundur të vërtetohet nga Sekretaria Ekzekutive. Për më tepër, Sekretaria Ekzekutive e ka gjetur, *ex officio*, një Certifikatë për të Drejtat e Pronës së paluajtshme në emër të një pale të tretë. Në bazë të provave deri atëherë, KKPK-ja konkludon se paraqitësi i kërkesës ka dështuar ta provoi pronësinë apo çfarëdo të drejte tjetër pronësore ndaj pronës së kërkuar, menjëherë para ose gjatë konfliktit të viteve 1998/1999.
15. E drejta pronësore mund të fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik (bartjes ligjore) apo trashëgimisë, neni 20 i Ligjit për Marrëdhënie Themelore Juridike Pronësore” (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr.6/1980), i zbatueshëm në kohën e bartjes së pretenduar të pronës (siç është cekur nga paraqitësi i kërkesës, bartja e pretenduar ka ndodhur në vitin 1997).
16. KKPK-ja ka bërë verifikimin negativ të Aktgjykimit P.Br.181/96 i datës 06 janar 1997, i lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë në të cilin J e bazon kërkesën e tij për pronësi.
17. Sipas nenit 33 Ligjit për Marrëdhënie Themelore Juridike Pronësore” (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr.6/1980), në bazë veprimit juridik (bartjes ligjore), e drejta pronësore ndaj pasurisë së paluajtshme mund të fitohet duke bërë regjistrimin në "regjistrin publik të noterit" (libri kadastral) ose në disa mënyra tjera të përshtatshme që përshkruhet me ligj.
18. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e ka gjetur *ex officio*, Certifikatën për të Drejtat Pronësore të Paluajtshme në emër të palës së tretë, të azhurnuar në bazë të deklaramit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, gjithashtu, madje para privatizimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit; prona e kërkuara ishte e regjistruar në emër të Kooperativës Bujqësore "AgroMorava".
19. Aktgjykimi P.Br.181/96 i datës 06 janar 1997, i lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë nuk ishte zbatuar asnjëherë siç është e specifikuar në dispozitiv të aktgjykimit. Nëna e paraqitësit të kërkesës nuk e ka fituar të drejtën pronësore pasi që kushtet e nenit 33 të Ligjit për Marrëdhënie Themelore Juridike Pronësore” (Gazeta Zyrtare RSFJ, nr.6/1980) nuk janë përmbushur.
20. Edhe pse Vendimi për trashëgiminë O.Br.139/99 i datës 19 korrik 1999, i lëshuar nga Gjykata Komunale e Jagodines e shpalli paraqitësin e kërkesës si bashkë-pronar ndaj ½ pjesë ideale, nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme për njohjen e të drejtës pronësore pasi që pronësia e nënës së paraqitësit të kërkesës nuk është vërtetuar.
21. Lidhur me kërkesën e palës ankuese për kompensim për shkak të shfrytëzimit të pronës pa pëlqimin e tij, sipas Ligjit nr. 03/L-079 as Komisioni e as Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme nuk kanë juridiksion ndaj kërkesave të tilla.

22. Ankesa e J.përsërit të gjitha pretendimet që i ka bërë para KKPK-së. Asnjë provë shtesë nuk është paraqitur bashkë me ankesën.
23. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka nxjerr një vendim korrekt, në bazë të procedurave të plota dhe korrekte. Si rrjedhojë Gjykata Supreme gjen se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim jo të plotë të fakteve. Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pabazuar.
24. Në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

25. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetar i kolegjit i EULEX-it

Esma Erterzi , Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it